



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E KANDIDATËVE TË LËNDËS**

**HISTORI**

**2019**

**I. HYRJE**

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës së historisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në lëndën e historisë.

Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- Programe lëndore të historisë.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të historisë.

**II. QËLLIMI I PROGRAMIT**

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës së historisë është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së historisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese. Programi synon:

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- Rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në efektivitetin e procesit mësimor.
- Rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të historisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së historisë.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi;</li> <li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>- demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>- zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>- respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>- respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>- zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>- Udhëzimi nr.27, datë 16.08.2018 “Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.</li> <li>- Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.</li> </ul>
<b>FUSHA: PROGRAME LËNDORE</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të historisë në shkollë”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza kurrikulare, 2014.</li> </ul>

<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> <li>- përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>- përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> <li>- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</li> <li>- harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit;</li> <li>- tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të historisë);</li> <li>- shpjegon lidhjen program - tekst nxënësi;</li> <li>- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave;</li> <li>- siguron informacion që demonstroi lidhjen e historisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014.</li> <li>- Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>- Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.</li> </ul>
---	--

<b>FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE</b>	
<b>Kompetenca I</b> <b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e historisë”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i historisë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>- identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> <li>- planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së historisë;</li> <li>- edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkshirëni ndaj lëndës së historisë;</li> <li>- motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>- krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>- punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017</li> <li>- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016.</li> <li>- Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018.</li> <li>- Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), nëntor 2018.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca II</b></p> <p><b>“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e historisë”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>

<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;</li> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>- planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>- përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>- zhvillon kompetencat dhe konceptet kyçe të historisë në mësimdhënien – nxënien e historisë;</li> <li>- demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>- shpjegon parimet e hartimit të një testi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017</li> <li>- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016.</li> <li>- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016.</li> <li>- Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018.</li> <li>- Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), nëntor 2018.</li> <li>- Udhëzuesi kurrikular lëndor i historisë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>- Udhëzuesi kurrikular lëndor i historisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në histori”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton materiale historike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word;</li> <li>- nxit nxënësit të bëjnë prezantime në histori duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>- gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënien- nxënien;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së historisë që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së historisë apo në projekte kurrikulare të integruara, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga Website.</li> </ul>	
---	--

**FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT**

<p align="center"><b>Kompetenca</b></p> <p align="center"><b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>- sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>- Draft Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA, 2016.</li> </ul>

**FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE**

<p align="center"><b>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>- demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

**FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

<b>Kompetenca</b> <b>“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së historisë”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e historisë në klasat 6-12;</li> <li>- përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve historike në klasat 6-12;</li> <li>- përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe të shprehive;</li> <li>- dallon ndërvarësinë e koncepteve historike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> <li>- përdor me saktësi dhe në situata të ndryshme konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave 6 -12;</li> <li>- kërkon dhe mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të historisë në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programe dhe tekste të lëndës së historisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.</li> </ul>